

ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË NË FMN  
DHE FILLIMET E REFORMËS  
EKONOMIKE

---

**Ylli Bufi**

**Kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Financave  
dhe Privatizimit, Kuvendi Republikës së  
Shqipërisë**

## **Të nderuar pjesëmarrës !**

Sot dhjetë vjet më pas, realisht kam arsye personale që të ndjem krenar që më takoi mua personalisht privilegji historik të nënshkruaja, në emër të Qeverisë Shqiptare, aktin formal të anëtarësimit të Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

15 tetori i vitit 1991, përveç një akti formal anëtarësimi, ka rëndësinë e madhe pasi për herë të parë që nga krijimi i institucioneve të Bretoon Woods, përkrah shumë demokracive të konsoliduara dhe shumë vendeve të tjera aspiruese për prosperitet demokratik e ekonomik, përfshiu dhe vendin tonë të vogël. Rëndësia e kësaj date nuk qëndron thjesht në një nënshkrim dhe anëtarësim.

Për Shqipërinë ky moment nënkuptonte ndezjen e dritës jeshile për të hyrë në të ardhmen e saj, e cila, në çdo rast mendohej si shumë më e mirë se sa e kaluara. Anëtarësimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore nuk do të konvertohej në një llogari huaje me këto dy institucione.

Kjo do të thoshte që Shqipëria kishte tashmë mundësi të përpunonte strategjitë e saja të kalimit të krizës dhe të zhvillimit, programet e ndihmave, programet e investimeve, programet e thithjes së investimeve të huaja dhe të teknologjisë së përparuar.

Kjo do të thoshte që Shqipëria mund të fillonte të zbatonte reformat në fushën ekonomike, sociale e në institucione, mund të niste proceset e hapjes e të liberalizimit me qëllimin e vetëm për të siguruar ndërtimin e demokracisë dhe zhvillimin e ekonomisë duke synuar në afat të gjatë integrimin në strukturat euro-atlantike.

Më sipër u shpreha që sot ndjehem krenar. Por, mos mendoni se edhe në atë periudhë ushqeja po këtë lloj ndjenje. Shqipëria po linte prapa një nga diktaturat më të egra të kohës dhe po përjetonte një krizë të shumanshme, ekonomike, politike dhe sociale.

#### **VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM**

Për mëse katër dekada me rradhë e deri në fillim të vitit 1991, Shqipëria ka qenë një nga vendet më pak të njohura dhe më të vështira për të kontaktuar në botë. Ajo u veçua nëpërmjet një vetizolimi total e drejtuar nga një regjim totalitar, i cili deklaronte se ndiqte me fanatizëm ideologjinë marksiste duke u përpjekur të realizonte një nga eksperimentet më të mëdha të ortodoksisë socialiste. Ndonëse nuk dihej shumë për ekonominë e vendit, Shqipëria është përshkruar gjithmonë si vendi më i varfër dhe më pak i zhvilluar në Europë, mbase dhe i vetmi vend në kontinent ku standardet e jetesës ishin të njëjta me ato të vendeve të botës së tretë.

Ndonëse në fillim u mendua se Shqipëria po i rezistonte ndryshimeve radikale që po ndodhnin në botën socialiste, në mes të vitit 1991 ajo ishte bashkuar me lëvizjen reformiste që kishte përfshirë Europën Lindore në atë kohë. Në qershor 1991 u krijua qeveria e parë e koalicionit pluralist që pas periudhës së luftës. U rinovuan marrëdhëniet diplomatike me shumë vende dhe Shqipëria u bashkua me Fondin Monetar Ndërkombëtar (15 tetor 1991), me Bankën Botërore, Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe me mjaft organizata të tjera ndërkombëtare.

Pamja që na shfaqej atë kohë, kur Shqipëria përpiqej të reformonte sistemin dhe të ribashkohej me komunitetin ekonomik botëror, ishte ajo e një ekonomie në qendër të një krize të thellë ekonomike ndoshta më serioze sesa ajo e vendeve të tjera socialiste në procesin e reformimit. Shqipëria kalonte një tkurrje drastike të aktivitetit ekonomik (prej 30-40 për qind gjatë vitit 1990-1991) rënie të theksuar të llogarisë së jashtme, varfërim të rezervave valutore dhe krijimin e shpejtë të borxhit të jashtëm.

Në këtë kontekst, informacioni i bërë i mundur vetëm kohët e fundit mbi variablat kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe financiar gjatë viteve të fundit dhe mbi komplikimet e politikës që është ndjekur, ndihmojnë për të kërkuar rrënjët e krizës së atëhershme. Ndonëse mund të thuhet se reformat radikale si braktisja e ekonomisë së centralizuar dhe përçafimi i ekonomisë së tregut do ta zhvendosin studimin e zhvillimeve më të fundit të ekonomive të vendeve në reformim në kontekstin e aspektit të historisë së ekonomisë, përsëri është e qartë se të kuptuarit e ngjarjeve dhe e kuadrit brenda të cilit kanë ndodhur këto zhvillime do të kontribuojë në hartimin e zgjidhjeve optimale.

Kriza e ekonomike në Shqipëri nuk ishte vetëm rezultat i ngjarjeve të fundit. Ajo reflektonte lindjen e problemeve strukturale, mangësitë në drejtim si edhe zhbalancimet financiare që i kishin rrënjët në hartimin e strategjive të ndjekura që pas Luftës së Dytë Botërore. Modeli ekonomik i Shqipërisë, sikurse edhe ato të vendeve të tjera lindore, bazohej në dy parime kryesore: mbështetja në planifikimin e centralizuar dhe heqja dorë nga prona private e mjeteve të punës. Edhe pse zbatimi i këtyre parimeve u bë në përmasa më ekstreme sesa në çdo vend tjetër socialist dhe u zhdukën të gjitha format e pronësisë private, modeli "shqiptar" është i veçantë, kryesisht sepse përfshinte edhe një parim të tretë: idealizimin e mbështetjes në forcat e veta që u bë edhe kredoja e politikës ekonomike dhe që praktikisht e vuri zbatimin e një ekonomie autokratike në plan të parë. Kjo strategji simbolizohej në barrierat konstitucionale që u vunë për kreditin nga jashtë, për ndihmat dhe për investimet në vitin 1976 dhe arriti kulmin kur në vitin 1981 Shqipëria u vetizolua financiarisht.

Deri në fund të viteve 1970, ekonomia shqiptare ndoqi të njëjtën rrugë zhvillimi me atë të disa vendeve të tjera në zhvillim, socialiste ose jo, përsa i përket shmangies së iniciativave ekonomike, rolit të forcave të tregut, konkurrencës dhe avantazheve të saj si dhe disiplinës financiare. Rrjedhimisht, aktiviteti ekonomik u dëmtua nga shtrembërimet e çmimeve, barra financiare e subvencionimeve të shtetit për ndërrmarjet si rezultat i sistemit të ngurtë të çmimeve fikse dhe nga specializimi i prodhimit, i cili çoi në mospërputhje të mëdha midis kërkesës dhe ofertës. Megjithatë, për një periudhë kohe, pasojat e këtyre politikave u maskuan nga përdorimi i konsiderueshëm i burimeve të huaja të marra nga ish-Bashkimi Sovjetik në vitin 1950 dhe nga Republika e Kinës në vitet 1960 dhe 1970. Transferimi i kursimeve të jashtme, jo vetëm që nuk vuri në pah efektet e akumuluarat të gabimeve të politikës, por

nxiti si një zhvillim të ngadaltë, por të sigurt ashtu edhe krijimin e një sasive të konsiderueshme të rezervave valutore.

Shqipëria filloi të eksperimentonte ndryshe nga të tjerët në vitin 1978 kur ajo i shkëputi marrëdhëniet ekonomike dhe financiare me Kinën dhe filloi të ndiente efektin e barrierës institucionale, që pengonte të gjitha format e ndihmës nga jashtë. Ndonëse shumë vende kanë mundur të përballen me mungesën e financimeve të jashtme, zakonisht kjo gjë kërkon ndryshimet përkatëse makroekonomike. Shqipëria nuk iu përshtat kushteve të reja dhe kërkesa agregate e ndikuar edhe nga rritja monetare dhe zhbalancimet fiskale vazhdoi të rritej me shpejtësi. Për më tepër, drejtimi i ekonomisë në kushtet e një autarkie financiare, kërkonte që të shtrëngohej kontrolli shtetëror dhe si rrjedhim keqësohej edhe shpërndarja e burimeve. Kjo solli përshpejtimin e rënies së prodhimit si rezultat i përpjekjeve të shtetit për të siguruar punësimin e forcës së punës që rritej me ritme të shpejta dhe i prapambetjes teknologjike të mjeteve të kapitalit, të cilat kishin qenë të tilla që në momentin e instalimit të tyre. Në kushte të tilla, zhvillimi i ekonomisë ra me ritme të shpejta nga 5 për qind në vitin 1970, në mesatarisht 1 për qind në vit, gjatë viteve '80.

Megjithatë, u arrit që kriza të shtyhej për mëse një dekadë si rezultat i grumbullimit të rezervave valutore në të kaluarën, i mbajtjes së bilancit tregtar kryesisht në monedhë të pakonvertueshme, i zhvillimeve pozitive në kushtet tregtare të Shqipërisë dhe i eksporteve e reja të mallrave. Me kohë, pasojat e akumuluarra nga intensifikimi i zhbalancimeve makroekonomike së bashku me rritjen e deficitit buxhetor, ekspansionin monetar (sidomos në pjesën e dytë të viteve '80) si edhe mungesën e mallrave të konsumit në treg, dolën në pah. Gjithashtu, në fund, rrjedhojat e shtrembërimeve mikroekonomike dhe mangësitë në drejtimin makroekonomik u qartësuan më shumë nëpërmjet rritjes së kërkesave të importit si rezultat i ngushtimit të ofertës së brendshme, i kolapsit të tregjeve të eksportit në vendet e Europës Lindore, i përmbysjes së kushteve tregtare dhe i varfërimit të rezervave valutore.

Në vitin 1990, situata fiskale u përkeqësua ndjeshëm dhe deficitit buxhetor arriti nivelin mbi 16 për qind të PBB-së. Paraja u rrit me mbi 20 për qind, ndërsa procesi i reformimit po bëhej shkarazi. Krejtësisht ndryshe nga politikat paraardhëse, të cilat nuk praninin financim nga jashtë, në këtë periudhë detyrimet ndaj bankave tregtare të huaja u rritën me shpejtësi duke dëmtuar reputacionin e Shqipërisë në tregun financiar ndërkombëtar. Ndonëse kushtet

atmosferike, veçanërisht të këqija gjatë vitit 1990, ndikuan në uljen e ndjeshme të prodhimit, kjo rënie vazhdoi edhe gjatë vitit 1991 e shoqëruar edhe me keqësimin e zhbancimeve fiskale. Në këto kushte, rruga drejt rimëkëmbjes kërkonte jo vetëm rregullime makroekonomike, por edhe restaurim rrënjësor të sistemit ekonomik nëpërmjet zbatimit të programeve të përgjithshme për transformimin strukturor dhe institucional.

## **DREJT REFORMËS EKONOMIKE**

Praktikisht, deri në vitin 1990, në Shqipëri nuk ishte ndërmarrë asnjë reformë ekonomike. Në vitin 1985, pas disa dekadash udhëheqjeje të centralizuar, qeveria filloi, pavarësisht se tepër ngadalë, të largohej nga përkushtimi ndaj parimit të mbështetjes në forcat e veta. Por, vetëm në mes të viteve 1990 në përgjigje të revoltave popullore, autoritetet shqiptare deklaruan se sistemi i planifikimit të centralizuar kishte rezultuar në grumbullimin e çekuilibrave seriozë. Brenda kornizës së “mekanizmit të ri ekonomik” që u adoptua në atë kohë, u prezantuan disa masa të kufizuara që kishin qëllim të integronin Shqipërinë në ekonominë botërore dhe të promovonin një kalim gradual nga planifikimi i centralizuar në një sistem tregu.

Qeveria Socialiste që u formua pas zgjedhjeve të marsit 1991 dhe Qeveria e Stabilitetit që u vendos në qershor 1991 megjithëse në kushtet e mungesës së theksuar të stabilitetit politik dhe të kohës së kufizuar të qeverisjes, filluan të hedhin hapat e parë të vështirë në rrugën e gjatë të reformës ekonomike. Në gusht 1991 Qeveria e Stabilitetit do t'i paraqiste Parlamentit paketën e parë të projektligjeve të reformës ekonomike. Pas miratimit të ligjit nr. 7512 datë 10.08.1991 “ Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë dhe të veprimtarive private të pavarura”, që do të përbënte bazën ligjore të të gjithë reformës ekonomike, u miratuan edhe një sërë ligjesh apo vendimesh të tjera, si ligji për ndërmarrjet, ligji për pagat dhe çmimet, ligji për asistencën, ndryshimet në ligjin për Bankën e Shtetit Shqiptar. Sidoqoftë, pavarësisht nga transformimet e mëdha që pësuan fusha të tilla si privatizimi i aktiviteteve bujqësore, liberalizimi i tregtisë dhe i çmimeve, pavarësia financiare e ndërmarrjeve shtetërore, shpejtësia e reformave ishte e vogël dhe masat për reformat u zbatuan shumë ngadalë nga administrata e dobët ekonomike. Situata politike u përkeqësua në dhjetor të vitit 1991, kur qeveria u gjend në krizë dhe u detyrua të lajmëronte zgjedhjet përpara afatit të caktuar-mars 1992.

## REFORMA TË SEKTORIT TË JASHTËM

Reformat e sektorit të jashtëm në Shqipëri janë përqendruar në heqjen e pengesave ligjore ndaj investimeve dhe kreditimeve të huaja dhe në liberalizimin e pjesshëm të tregtisë së jashtme dhe kushtëzimeve të këmbimit.

Në korrik 1990, nga Parlamenti Shqiptar u aprovuan dy dekrete (Dekreti nr. 7406 “Mbi mbrojtjen e investimeve të huaja në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe dekreti nr.7407 “Mbi aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.) të cilat hoqën pengesën kushtetuese ndaj marrjes së kredive nga jashtë, të vendosur në vitin 1976.<sup>1</sup> Dekretet lejuan investimin e huaj direkt, vendosën mbrojtje ligjore ndaj shpronësimit dhe nacionalizimit arbitrar dhe lejuan krijimin e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët (të huaj dhe shqiptar) si edhe dërgesat e përfitimeve jashtë shtetit.

Traktate të dyanshme për investime u nënshkruan më tej me vende të ndryshme partnere dhe në gusht 1991 Ministria e Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë ngriti Agjencinë e Investimeve të Huaja, e cila ishte përgjegjëse për promovimin e investimeve dhe analizën e propozimeve të marra për investim.

Në gusht 1991, Shqipëria filloi liberalizimin e tregtisë dhe të sistemit të këmbimit. Deri atëherë tregtia ishte bërë me një numër të kufizuar monopolesh tregtare nën kontrollin e qeverisë. Pas gushtit 1990, të gjitha ndërmarrjet shtetërore ishin të autorizuar të bënin operacione të tregtisë së jashtme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në prill të vitit 1991, pas vendimit të Këshillit të Ministrave për privatizimin, monopoli shtetëror mbi tregtinë e jashtme mori fund, duke iu lejuar kështu ndërmarrjeve dhe individëve të ndërmerrnin operacione të tregtisë ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga shteti. Shpërbërja graduale e monopolit shtetëror mbi tregtinë e jashtme u shoqërua nga prezantimi (në dhjetor 1990) i një sistemi të licencimit të importit dhe eksportit dhe të të drejtave të kufizuara të mbajtjes së valutave, i cili u zgjerua në prill 1991 me fitimet nga eksporti të ndërmarrjeve private.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> E gjithë Kushtetuta u shfuqizua në prill 1991. Parlamenti i zgjedhur në mars 1991 kaloi ligjin nr. 7491 me titull “Nene themelore kushtetuese”, i cili konfirmoi masat liberalizuese të prezantuara në këto tre dekrete.

<sup>2</sup> Incentivat fiskale për formimin e ndërmarrjeve të përbashkëta me investim të kapitalit të huaj përfshinin taksa të ulura mbi fitimin për një periudhë dyvjeçare.

Që nga gushti 1991 eksportet dhe importet janë liberalizuar me përjashtim të një liste me mallra, që kërkonin leje të veçantë nga Ministria e Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë dhe ndalimit të eksportit të disa mallrave ushqimorë në të cilat vendi kishte mangësi. Që prej janarit 1991, e gjithë tregtia është kryer në monedha të konvertueshme, të gjitha pagesat e dyanshme janë denominuar në dollarë dhe kurset e këmbimit për transaksionet tregtare ose jotregtare nuk kanë më dallim nga njëri-tjetri. Që nga shtatori 1991 kursi i këmbimit zyrtar ka qenë i lidhur me monedhën europiane ECU (në normën 1 ecu=30 lekë) pavarësisht se realisht mbizotëronte lidhja me monedhën amerikane, në nivelin 1 usd=25 lekë (në krahasim me 1 usd=10 lekë në fillim të vitit 1991).

Me humbjen e kontrollit të qeverisë mbi kërkesat për dorëzimin e valutave të huaja dhe me shterimin, pothuajse të plotë të rezervave valutore, në fillim të vitit 1992, kursi zyrtar u zhvlerësua më tej duke arritur në nivelin 1 usd=50 lekë. Transaksionet në tregun paralel të valutës erdhën duke u rritur, dhe e çuan kursin e këmbimit nga vlerat 40/ 43 lekë/usd në nëntor 1991, në vlerat 78-81 lekë/usd në shkurt 1992.

#### **REFORMAT NË EKONOMINË E BRENDSHME**

Reformat e ekonomisë së brendshme kishin si qëllim të modifikonin kornizën ligjore dhe institucionale që rregullonte aktivitetet ekonomike, duke lejuar iniciativat private, duke siguruar ndihmë të kufizuar financiare për zhvillimin e sektorit privat dhe duke rritur pavarësinë financiare të ndërmarrjeve private në lidhje me buxhetin.

Sidoqoftë, duke qenë se kontrollet mbi çmimet e pjesës më të madhe të mallrave vazhduan deri në fund të tetorit 1991, shpërbërja e sistemit të centralizuar të ndarjes së burimeve nuk u shoqërua me prezantimin e njëkohshëm të nxitjeve të dukshme të tregut. Mungesa e zgjatur e fleksibilitetit në çmime, prishja e kornizës institucionale për menaxhim, mosinkurajimi i punonjësve që paguheshin me 80 për qind të pagës duke mos punuar, dhe mungesat akute të lëndëve të para penguan përgjigjen nga ana e ofertës së ekonomisë dhe ndikuan në përkeqësim të çekuilibrave financiarë.

Reformat ligjore dhe institucionale e zvogëluan në mënyrë të konsiderueshme rolin e planifikimit të centralizuar dhe nisën t'i afroreshin çështjes së të drejtave të pronësisë. Në mars-prill 1991 qeveria vendosi të braktiste planin tradicional pesëvjeçar dhe ta

zëvendësonte atë me një numër objektivash, tregues vjetorë për vitin 1991, nën një "plan operativ". Këta objektiva u vunë në kontekstin e një shkatërrimi të shpejtë të disiplinës së punës që kishte filluar që në vitin 1990 në mbarë vendin. Gjithashtu, që nga mars-prilli 1991 me dekretin nr.7476 "Mbi lejen dhe mbrojtjen e pronësisë private dhe aktiviteteve private" dhe nëpërmjet provigjoneve parapërgatitore kushtetuese të miratuara nga Parlamenti, pronësisë private të të gjitha llojeve (përveç tokës fillimisht) iu lejua dhe iu garantua mbrojtje e barabartë ligjore me atë që gëzonin forma të tjera të pronësisë, qofshin publike, të përziera apo të përbashkëta.

Privatizimi u mendua fillimisht si një hyrje private në industri të shkallës së vogël, të tregtisë dhe të shërbimeve. Në të njëjtën kohë, do të vazhdohej ndarja e ndërmarrjeve të mëdha në njësi më të vogla, dhe më pas këto ndërmarrje të mëdha do t'i shiteshin publikut. (Vendimi nr.138 "Mbi zhvillimin e aktivitetit privat" i miratuar nga Parlamenti në 3 prill 1991, i kërkonte Qeverisë të identifikonte sektorët dhe ndërmarrjet shtetërore që do të privatizoheshin.) Në legjislacionin dhe vendimet e miratuara në gusht 1991, çështja e privatizimit ishte përsëri e pranishme. Në drejtimin e Komisionit Përgatitor të posaçërisht formuar për Procesin e Privatizimit (KPPP) dhe të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP), ndërmarrjet shtetërore do të shiteshin në ankand nëpërmjet aksioneve, do të ndaheshin me pjesë ose aksione që kapnin deri në 30 për qind të vlerës së kompanisë, ose do të privatizoheshin nëpërmjet një kombinimi të këtyre metodave. KPPP ishte përgjegjës për vlerësimin e aseteve shtetërore dhe AKP për ndërmjetësimin midis shtetit dhe blerësve dhe për realizimin final të shitjes së ndërmarrjeve shtetërore. Shitja e aseteve shtetërore u bë duke u dhënë opsionin e parë për blerje punonjësve të ndërmarrjes dhe pastaj duke e vënë në ankand për të gjithë qytetarët shqiptarë. Asetet që nuk shiteshin as me opsionin e dytë, iu ofruan individëve apo kompanive të huaja. Fitimet u transferuan në buxhetin e shtetit.

Aktiviteti i sektorit privat është rritur në një masë të kufizuar. Në fillim të vitit 1992 kishte përparuar vetëm privatizimi i dyqaneve të vogla dhe shërbimeve tregtare, ndërkohë që ishte privatizuar vetëm 20 për qind e ndërmarrjeve në industrinë ushqimore. Një sërë aktiviteteve tregtare private janë krijuar në tërë vendin duke i dhënë një shtysë krijimit të tregut paralel. Në janar 1991 nisi mbështetja financiare për krijimin e iniciativës private nëpërmjet zbatimit të një programi afatmesëm për kreditimin e tyre (niveli maksimal i kredisë së dhënë për çdo projekt ishte 40,000 lekë)

megjithatë, kreditë e dhëna në këtë kuadër, gjatë vitit 1991, përbënin një pjesë mjaft të vogël të totalit të kredisë së brendshme.

Në sektorin bujqësor dhe atë të tregtisë agrare, reformat përparuan më shpejt. Që në gjysmën e vitit 1990 është lejuar krijimi i tregut paralel privat të prodhimeve bujqësore nga ngastrat që më parë punoheshin nga kooperativistët për nevoja të vetëkonsumit. Çmimet në këto tregje u vendosën nga tregu dhe volumi i transaksioneve u rrit së pari, si rezultat i rritjes së sipërfaqes së ngastrave për anëtarët e kooperativës dhe pas tremujorit të parë të vitit 1991, si rezultat i shpërbërjes së kooperativave bujqësore. Kriteret për shpërndarjen e tokës dhe të pasurisë së kooperativës (e cila zotëronte 75-80 për qind të tokës së punueshme) u përcaktuan nga Këshilli i Ministrave në gusht të vitit 1991, pasi u bë shpërndarja e një pjese të gjësë së gjallë midis anëtarëve të kooperativës. Deri në mes të vitit 1992, 70-75 për qind e tokës së punueshme, që më parë zotërohej nga kooperativat, ishte shpërndarë midis individëve privatë. Toka mund të trashëgohej tek pasardhësit, por ligji i miratuar në korrik të vitit 1991 ndalonte shitjen e saj. Për më tepër, mangësi serioze në fushën e transportit, të shpërndarjes dhe marketingut për produktet bujqësore pengonin zhvillimin e aktiviteteve fermere. Reformimi i fermave shtetërore nisi në gjysmën e vitit 1992.

Pas gjysmës së vitit 1990 një numër reformash u ndërmorën për të rritur pavarësinë financiare të ndërmarrjeve shtetërore. Thelbi i këtyre reformave ndikonte në prurjet financiare midis ndërmarrjeve shtetërore dhe buxhetit të shtetit dhe synonte t'i bënte këto ndërmarrje më të përgjegjshme për vendimet e tyre për investimet. Më konkretisht, raporti i fitimeve të mbajtura nga ndërmarrja u rrit nga më pak se 10 për qind në 90 për qind, ndërsa investimet që më parë financoheshin nga buxheti, në këtë periudhë nisën të financoheshin nga fondet e ndërmarrjes dhe kreditë nga bankat.

Projektet për investime të mëdha si ato për sistemin e ujitjes, hidrocentralet dhe aktivitetet kërkimore ishin ende nën varësinë financiare të buxhetit të shtetit, ndërkohë që vazhdonin të financoheshin nga buxheti i shtetit, edhe humbjet e ndërmarrjeve. Humbjet e ndërmarrjeve filluan të financoheshin edhe nga krediti bankar, i cili në praktikë, iu jepej ndërmarrjeve shtetërore në gjendje jo të mirë financiare dhe pa kushte. Gjithashtu, decentralizimi i prodhimit, vënia e çmimeve dhe vendimet për nivelin e pagave u panë nga ana ligjore vetëm në tremujorin e fundit të vitit 1991. Ligji mbi ndërmarrjet shtetërore, i publikuar në tetor të vitit 1991 sanksiononte në parim pavarësinë e

ndërmarrjeve në lidhje me strukturën e prodhimit, me nivelin e forcës punëtore të punësuar, me vendosjen e pagave dhe të çmimeve, dhe të drejtën për të prodhuar mbi bazë kontraktuale. Megjithatë, ligji përmbante dhe kufizime të rëndësishme. Shteti kishte të drejtën të kontrollonte 2/3 e kapacitetit prodhues të ndërmarrjeve dhe, në raste të veçanta, kjo ndërhyrje shkonte deri në 100 për qind. Po kështu, edhe punësimi mbeti nën kontrollin e autoriteteve qendrore ose të atyre lokale, ndërkohë që megjithë liberalizimin e çmimeve në nëntorin e vitit 1991 përsëri një pjesë e madhe e tyre ishin akoma nën kontrollin shtetëror.

#### **NË VEND TË MBYLLJES**

Më vjen më shumë se mirë dhe sinqerisht provoj ndjenjën e një kënaqësie të qetë, kur shikoj që fillimi nuk mbeti vetëm i tillë.

Ne, të gjithë të bashkë, me dëshirë të mirë dhe përpjekje të mundimshme, nganjëherë të ngarkuar me emocione dhe inate, të shfaqura më hapur se ç'mund të pranojë politika e përpunuar e një vendi që synon Europën, kemi bërë shumë. Shumë më tepër nga sa dhe vetë ne i atribuojmë vetes.

Dhe gjej përsëri një arsye për t'u ndjerë mirë. E mbështes në modestinë time dhe të homologëve të mëpastajmë, të pranishëm ose jo në këtë sallë. Sepse të gjithë ne, së bashku, dhe pavarësisht nga njëri-tjetri, i dhamë Shqipërisë shpresën dhe besimin për të synuar Europën, i dhamë bashkëkombasve tanë, brenda dhe jashtë kufijve të vijëzuar në hartë, një motiv të qëndrueshëm dhe bindës për t'u krenuar, për të qenë të vëmendshëm për çfarë po ndodh në Shqipëri.